

Letër Informative

Nr. 1 • Shtator 2009

Mileniumi i Tretë

Fillimi i vitit të ri shkollor

Me qëllim që procesi mësimor të jetë më efikas, në shkollën tonë, "Mileniumi i Tretë", gjatë pushimeve verore janë bërë të gjitha përgatitjet për vitin shkollor 2009/10, si: ngjyrosja e objekteve, pajisjet për kabinete të shkencave, vendosja e projektorëve dhe kamerave nëpër të gjitha dhomat mësimore, mjetet e materialet sanitare, mësimore, pranimi i stafit të ri etj. Të gjitha këto aktivitete kanë mundur një fillim të mbarë të vitit të ri shkollor.

Shkolla, "Mileniumi i Tretë", këtë vit ka 485 nxënës, nga të cilët 263 nxënës janë nga klasa 1 – 5 dhe 222 nxënës nga klasa 6 – 10.

Gjithashtu, risi e këtij viti është se shkolla ka zgjeruar veprimtarinë e saj me hapjen e 2 paraleleve të gjimnazit me dy drejtime: Matematikë-informatikë dhe Shoqëror.

Pra, është bërë një avancim në mësimdhënien e shkollës sonë me qasjen e drejtpërdrejtë në teknologji – internet nëpër të gjitha klasat. Njëkohësisht, planifikohet rritje e aktiviteteve mësimore dhe jashtëmësimore.



Redaksia

Kryeredaktore

Zana Buçinca

Redaktore

Buena Aziri

Anëtarë të redaksisë

Dina Spahiu

Arian Dobërçani

Donika Kryeziu

Plarenta Deshishku

Vesa Reçica

Vesa Hoxha

Abetare Kabashi

Dion Krapi

Diona Halili

Luneta Sahiti

Jon Latifi

Artmir Azizi

Kampi veror në Bullgari

Me qëllim që nxënësit e shkollës sonë të jenë në hap me moshatarët e tyre në tërë botën, në Universitetin Amerikan të Bullgarisë (AUBG), nga data 5. 7.2009 deri më datën 25. 7.2009 u organizua një kamp veror për nxënësit e moshave 15-18 vjeç. Shkolla jonë ndau bursa për 15 nxënës të saj pjesëmarrës në këtë kamp. Kampi në fjalë kishte për qëllim përvetësimin në shkallë të lartë të gjuhës angleze, njëkohësisht edhe njohjen e kulturave të ndryshme. Anëtarët e kampit i përkisnin 7 përkatësive të ndryshme etnike, si: Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Bullgarisë, Bjellorusisë, Kërgizistanit dhe Francës.



Në kamp zhvilloheshin kurse nga fusha të ndryshme, si në fushën e:

Business, Computer skills, Writing skills, Journalism, Performing arts. Prej këtyre kurseve anëtarët e kampit duhej t'i përzgjidhnin tre kurse, pasi që secili kurs zgjaste nga një javë, ndërsa kampi zgjaste gjithsej 3 javë. Përveç kurseve, të cilat mbaheshin paradite kampistët merrnin pjesë edhe në aktivitete të ndryshme, të cilat i përzgjidhnin çdo ditë sipas dëshirës. Ndërsa, në mbrëmje ata ishin të ndarë në grupe, ku luanin lojëra të ndryshme argëtuese.

Gjatë kësaj periudhe tre javore, përveç gjuhës angleze, anëtarët e kampit përvetësuan edhe shumë aftësi dhe shkathtësi të tjera. Puna e tyre, gjatë këtij kampi u shpërblye me nga një certifikatë.



Funksionimi i klubeve në shkollën tonë

Viti i ri shkollor ka sjellë një frymë të re edhe në klubet e shkollës tonë. Tani, në kuadër të klubeve janë shtuar edhe dy klube të reja. Nxënësit, të cilët janë të interesuar në arte marciale, përkatësisht në karate, këtë vit janë anëtarësuar në klubin e karatesë. Ky klub u mundëson nxënësve mësimin e bazave të arteve marciale dhe teknikave të karatesë. Për nxënësit, që dëshirojnë ta zhvillojnë logjikën e tyre përmes argëtimit është formuar edhe klubi i lojërave logjike. Rubikoni, Sudoku, fjalëkryqet dhe shumë lojëra të tjera logjike do t'i argëtojnë këtë vit nxënësit pjesëmarrës të këtij klubi.

Krahas formimit të klubeve të reja, klubet tjera vazhdojnë funksionimin e tyre. Shahistët e shkollës, vazhdojnë ta perfeksionojnë lojën e shahut dhe rregullat e saj në klubin e shahistëve. Në anën tjetër, nxënësit e aftë për aktrim janë mbledhur në klubin e dramës. Klub, ky në gjuhën angleze, i cili përgjatë shfaqjeve teatrale u mundëson nxënësve edhe përvetësimin e gjuhës.

"Teatër dhe kinema" është një klub tjetër që ka tërhequr nxënësit e pasionuar pas filmit. Në këtë klub, nxënësit janë ata që ndërtojnë rolet dhe analizojnë elementet e filmit. Kreativitetin e tyre, nxënësit edhe këtë vit mund ta shprehin në klubin e Skenografisë, kostumografisë dhe argjilës.

Ndërmarrësit e ardhshëm, hapat e tyre të parë në këtë fushë kanë vendosur t'i marrin në klubin e ndërmarrësisë. Mësimi i ndërmarrësisë, në këtë klub zhvillohet në gjuhën angleze. Një përparësi, e cila u mundëson nxënësve adaptimin me terminologjinë e biznesit mbarë botëror.



Llojlojshmëria e klubeve vazhdon tek klubi "Arts & Crafts", klub ky në të cilin nxënësit shprehin aftësinë e tyre krijuese. Klubi "Lyrics" është një klub tjetër, në të cilin nxënësit merren me përkthimin e teksteve të këngëve dhe analizimin e tyre. Përgatitjen e ushqimeve dhe mirësjelljen në tryezë, këtë vit e bën të mundur klubi "Kuzhina dhe maniret".

Historianët e rinj këtë vit janë mbledhur në klubin "Dardanët". Filmat historikë, dokumentarët, ekskursionet dhe debatet janë ato me çfarë do të merren këtë vit historianët e rinj.



Të interesuarit në programe kompjuterike këtë vit janë anëtarësuar në klubin e informatikës. Ndërsa, nxënësit e interesuar veçanërisht në krijimin e ueb faqeve janë anëtarësuar në klubin *Bazat e krijimit të ueb faqes*.

Për nxënësit, të cilët orët e fizikës janë të pamjaftueshme për të zhvilluar eksperimente të shumta dhe për hulumtime më të hollësishme në fusha të ndryshme të fizikës vazhdon funksionimin klubi i fizikanëve të rinj.

Ndërsa, nxënësit të cilët futbollin e kanë pjesë të pandashme të ditëve të tyre, mund të mësojnë më shumë për teknikën dhe taktikën e lojës në Klubin Futbollistik "M3".

Gjithashtu, biblioteka e shkollës do të jetë gjithmonë e hapur për nxënësit të cilët dy orët e fundit të së premtes dëshirojnë t'i kalojnë duke lexuar.

Dhe, klubi i cili ka mbetur pa përmendur është pikërisht klubi i letrës informative dhe revistës "M3". Klub, që kemi për detyrë t'ju informojmë dhe të sjellim në duart tuaja të rejat e shkollës.



Projekti për nxënës me mbipeshë

Nxënësit e shkollës sonë, këtë vit, do të mund ta humbasin peshën e tepërt, përmes nismës së projektit të profesorit të edukatës fizike, z. Driton Mamaj. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin dhe zhvillimin psiko-motorik të nxënësve. Humbja e peshës së panevojshme realizohet përmes ushtrimeve të ndryshme fizike. Këtu, nuk bëhet fjalë për mbajtjen e ndonjë diete, por vetëm mënjanimin e vetive jo të mira të të ushqyerit.

Nxënësit pjesëmarrës në këtë projekt, përveç orëve të edukatës fizike, dy herë në javë, gjatë orëve të studimit bëjnë ushtrime shtesë.

Projekti në fjalë, përveç humbjes së peshës, synon edhe vetëdijësimin e nxënësve rreth të ushqyerit të shëndetshëm dhe mbajtjen e vazhdueshme të trupit në gjendje të mirë shëndetësore.

Rëndësia e leximit të veprave letrare

Që në fillim të vitit shkollor arsimtarët e gjuhës shqipe ua japin nxënësve, listat e veprave që duhen lexuar dhe bërë referate gjatë tërë vitit shkollor. Në këtë listë përfshihen librat që janë të përshtatshëm për moshën e nxënësve dhe që kanë karakter edukativ dhe mësimor. Qëllimi i leximit të veprave është që nxënësit të përvetësojnë mirë të lexuarit e më pas të kuptojnë dhe analizojnë veprat e ndryshme letrare, të cilat japin porosi jetësore për nxënësit. Gjithashtu, përmes të lexuarit, nxënësit kultivojnë lart kulturën e shkrimit dhe të folurit bukur e rrjedhshëm. Gjatë çdo muaji nxënësit kanë për detyrë të lexojnë veprën letrare të caktuar, ta bëjnë referat dhe në fund të bëhet edhe prezantimi i veprës, goftë përmes punës me shkrim, powerpoint, po ashtu edhe si prezantim i zakonshëm përmes tryezës së rrumbullakët, në të cilën nxënësit dalin në pozitë e personazheve; bëhen vetë personazhe duke i analizuar dhe interpretuar veprimet e tyre.

Nxënësit që arrijnë të lexojnë veprën letrare, të punojnë referatin dhe të jenë pjesë aktive e prezantimit vlerësohen me nota të shkëlqyeshme.

Në kuadër të gjithë këtij aktiviteti mësimor, klasat e gjashta më 8 tetor 2009 i bënë vizitë Bibliotekës universitare "Toena" dhe shtëpisë botuese "Albas". Aty nxënësit panë librat shkollorë që duhen lexuar. Kjo vizitë u bë me qëllim që nxënësit ta kenë më të lehtë gjetjen e librave dhe të krijojnë shprehje të mirë, duke vizituar vendet ku lexohet dhe shitet libri.



Biblioteka e shkollës "Mileniumi i Tretë"

A do të kishte kuptim kjo shkollë e veçantë pa një bibliotekë të veçantë? Sigurisht që jo, sepse shkolla "Mileniumi i Tretë" ka një bibliotekë të pasur me libra fushash të ndryshme, si në gjuhën shqipe, po ashtu edhe në gjuhët e huaja. Biblioteka e shkollës është vendi më i veçantë në shkollë, aty ka raftet të mbushur me libra të të gjitha lëmive, të cilat pasurojnë mendjen e nxënësve. Biblioteka në fjalë, me titujt e librave që posedon, i plotëson të gjitha kërkesat e nxënësve, si gjatë aktiviteteve mësimore, po ashtu edhe gjatë atyre jashtëmësimore.

Vizitë "Rilindjes"

Si temë të javës, klasat e treta këtë javë kishin "Librin". Me qëllim që të mësonin diçka më shumë rreth botimit të librit, nxënësit vizituan shtypshkronjën "Rilindja", më datën 25.9.2009. Kjo vizitë, u mundësoi atyre të shihnin nga afër shtypjen, palosjen dhe libërlidhjen e librave, që ata i kishin çdo ditë në duar. Mësueset dhe nxënësit janë shumë falënderues ndaj punëtorëve të shtypshkronjës, të cilët u treguan të gatshëm edhe pse nuk ishte sezoni i libërlidhjes, t'ua demonstroi këtë proces.



Vizita në Muzeun e Kosovës

Shkolla "Mileniumi i Tretë", më 29.09.2009, organizoi një vizitë për klasat e pesta në Muzeun e Kosovës. Vizita u organizua me rastin e mësimin në lëndën e Historisë. Qëllimi i saj ishte, që nxënësit të fitojnë më shumë njohuri për të kaluarën e vendit tonë. Ciceroni u tregoi nxënësve të gjitha hollësitë për trashëgiminë e të parëve tanë, si: stoli, armë të ilirëve, statuja, mbishkrime, papiruse etj. Në oborrin e muzeut, nxënësit patën mundësi t'i shohin disa lloje të tankeve të periudhave të ndryshme historike. Fare në fund, nxënësit vizituan një varr, në të cilin arkeologët kishin gjetur stoli të vjetra dhe mjaft të rëndësishme.

Kampi ditor në K.F. "2 Korriku"

Më datën 01.10.2009, shkolla "Mileniumi i Tretë", organizoi një kamp njëditor në stadiumin e futbollit "2 Korriku".

Në këtë kamp morën pjesë nxënësit e ciklit të ulët, klasa 1 - 5. Mësimdhënësit e Edukatës fizike, Driton Mamaj dhe Edona Cami, së bashku me disa trajnerë të tjerë të shkollës së futbollit, kishin organizuar lojëra të ndryshme për t'iu sjellë argëtim nxënësve. Fusha e madhe e futbollit, në të cilën ndodheshin nxënësit, ishte e ndarë në disa stacione. Çdo stacion kishte trajnerë të ndryshëm, të cilët argëtonin fëmijët e vegjël. Gjatë këtij kampi ditor u zhvilluan lojëra të ndryshme, të cilat ishin mjaft argëtuese, pasi që lojërat shoqëroheshin edhe me muzikë. Nxënësit e kësaj shkolle u kthyen të kënaqur nga dita që kishin kaluar.

